



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

---

**V E N D I M**  
**Nr. 41, date 24.06.2019**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E ZNJ. DHURATA SULEJMANI DHE Z.BESNIK ADEMI, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 24.06.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 82, datë 20.12.2018 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Bashkisë Shkodër”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së znj. **Dhurata Sulejmani** (3 anëtarë familje) në vlerën prej **60.000 lekë** (*gjashtëdhjetë mijë*), për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
2. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Besnik Ademi** (6 anëtarë familje) në vlerën prej **100.000 lekë** (*njëqind mijë*), për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
3. Burimi i financimit është fondi i emergjencave civile në programin P03280 “Mbrotjtja nga zjarri dhe mbrotjtja civile” në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin

2019, në programin P03280, O1 A2 “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 160,000 lekë.

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjet znj. Dhurata Sulejmani dhe z.Besnik Ademi.
5. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën **309,396 lekë** (*treqind e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë*) dhe atë në orendi, mobilje, dhe elektroshtëpiake, në vlerën prej **266,400 lekë** (*dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind*), sipas preventivava të komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e znj. Dhurata Sulejmani.
6. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën **514,757 lekë** (*pesëqind e katërbëdhjetë mijë e shtaëqind e pesëdhjetë e shtatë*) dhe atë në orendi, mobilje, dhe elektroshtëpiake, në vlerën prej 274,160 (*dyqind e shtatëdhjetë e katërmijë e njëqind e gjashtëdhjetë*), lekë, sipas preventivava të komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. Besnik Ademi.
7. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjet e znj. **Dhurata Sulejmani** dhe z. **Besnik Ademi**, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
8. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 160,000 lekë (*njëqind e gjashtëdhjetë mijë*).
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 24.06.2019

Shpallur në datën 25.06.2019

**Sekretar i këshillit**

**K R Y E T A R**

---

**Suel Hadri**

---

**Xhemal BUSHATI**